



► GJATË TAKIMIT ME GRUPIN E PUNËS PËR KRULIMIN E "PAVLJONIT TË DEDIKUAR PËR DIASPORËN NË MUZEUM HISTORIK KOMBËTAR"



► GJATË TAKIMIT TË RADHËS PËR PANELET E DISKUTIMIT "VOTA SË DREJTË" DHE "ZHVILLIMI EKONOMIK I QENDRUESHËM"



► GJATË TAKIMIT TË RADHËS PËR PANELET E DISKUTIMIT "IDENTITETI SHQIPTAR, E ARDHMA FILLON NGA DIASPORA" DHE "FITESE NGA SHITEPIA JULI"



AGJENCIA KOMBËTARE E DIASPORËS



FONDI SHQIPTAR PËR ZHVILLIMIN E DIASPORËS



QENDRA E BOTIMEVE PËR DIASPORËN

#7

NEWSLETTER E DIASPORËS

REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRI I SHTETIT PËR DIASPORËN

PËRFAQËSIMI DHE NXITJA E POLITIKAVE TË BASHKËPUNIMIT DHE TË NDËRVEPRIMIT ME TË GJITHË SHQIPTARËT, DUKE NXITUR E FUQIZUAR BASHKËPUNIMIN NË TË GJITHA FUSHAT ME SHQIPTARËT JASHTË KUFIJVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRIE DHE SHTETET KU ATA BANOJNË

Bursat e studimit jashtë vendit, miratohet koordinatori shtetëror

Kryeministri ka miratuar propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën për përcaktimin e koordinatorit shtetëror për ndjekjen e programeve dhe donatorëve, të cilët ofrojnë bursa studimi për jashtë vendit, zëvendësministrin e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, z. Redi Shtino.

Zv. ministri për Arsimin, Sportin dhe Rininë do të jetë përgjegjës dhe autorizohet të koordinojë punën ndërinstitucionale për ndjekjen dhe realizimin e masës 64, të planit të veprimit, të Strategjisë Kombëtare për Diasporën,

sipas të cilës koordinatori duhet të rishikojë dhe orientojë programet dhe donatorët të cilët ofrojnë bursa studimore për jashtë vendit drejt fushave të ekspertizës për të cilat ka nevojë Shqipëria, si dhe vlerësimin e kryerjes së një studimi të thelluar mbi numrin e studentëve shqiptarë në universitetet jashtë vendit dhe mbi fushat ku ata specializohen. Më poshtë mund të lexoni urdhrin e plotë:

<https://diaspora.gov.al/wp-content/uploads/2019/02/URDHER-PER-KOORD-SHTETEROR-PER-BURSAT.pdf>

28

SHKURT

SAMITI I IIND I DIASPORËS

- 14:00 Regjistrimi i pjesëmarrësve në Samit ▶ [Pajtim](#) / [Empajtim](#)
- 19:00 Mbledhja në Tiranë - Ceremonia e mbylljes së pjesëmarrësve në Samit ▶ [Pajtim](#) / [Empajtim](#)
- 20:30 Mbledhje e lirë

Ministri ndjek konferencën "Diaspora shqiptare, pikënisje për formimin dhe zhvillimin e Europës"



Diaspora shqiptare, pikënisje për formimin dhe zhvillimin e Europës", ishte tema e konferencës së organizuar nga "Integra Onlus", në Itali dhe fondacioni "Ura për të ardhmen", në të cilin mori pjesë ministri i Shtetit për Diasporën.

Gjatë këtij takimi u diskutua për një bashkëpunim strategjik mbi tema thelbësore të politikave migruese, duke u përqendruar në veçanti të roli që kanë Diaspora të ndryshme si ura mes vendeve dhe kulturave të ndryshme, rëndësinë e dialogut social dhe fetar, në një vizion të përbashkët, me qëllim integrimin e popujve në një perspektivë të përbashkët europiane. Ky ishte diskutimi i parë i një cikli të plotë seminaresh të cilët do të mbahen në të ardhmen me fokus kryesor Diasporën.

01

MARS

SAMITI I IIIND I DIASPORËS

- 09:00 Njësia drejt vendit ku do të mbahet Samiti ▶ [Pajtim](#) / [Empajtim](#)
- 09:30 Mbledhja në Shqipëri e Diasporës ▶ [Pajtim](#) / [Empajtim](#)
- 10:00 Seion Kuvendues Plenar i Diasporës Shqiptare me Pjesëmarrjen e Autoriteteve Evropare ▶ [Pajtim](#) / [Empajtim](#)
- 11:15 Pushim kafeje ▶ [Pajtim](#) / [Empajtim](#)

Zhvillohet seminari I dytë për "Zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Diasporën"

U zhvillua seminari i dytë me grupin ndërinstitucional të punës për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Diasporën. I pranishëm në këtë takim ministri i Shtetit për Diasporën, z. Pandeli Majko në fjalën e tij vlerësoi bashkëpunimin me IOM dhe konsulentët që kjo organizatë ka dhënë në procesin e rishikimit të strategjisë për Diasporën.

Ky takim mes grupit ndërinstitucional i punës dhe konsulentëve ndërkombëtarë Dr. Martin Russell, Liza Gashi dhe Raimonda Duka diskutoi për vlerësimin dhe shqyrtimin e Strategjisë Kombëtare për Diasporën në kuadër të programit "Angazhimi i Diasporës Shqiptare në Zhvillimin Social dhe Ekonomik të Shqipërisë".

SAMITI I IIND I DIASPORËS

- 11:30 Paneli Diskutimi Paralel ▶ [Pajtim](#) / [Empajtim](#)
Vota si e Drejtë!
Politika e Re Shtetërore për Diasporën
Diaspora dhe të ardhurat nga të ardhurat
Zhvillimi Ekonomik i Qendrueshëm
Vendndja dhe Diaspora
Ekonomia, Biznesi, Shërbimet
- 13:30 Seion Përmbyllës Konkluzionet e Diskutimeve dhe Dokumenti Përfundimtar i Samitit Në Kushtet e shprehjes së 2018 ▶ [Pajtim](#) / [Empajtim](#)
- 15:00 Njësia drejt vëndere të drektës ▶ [Pajtim](#) / [Empajtim](#)
- 18:30 Mbledhja në Mbledhjen Gala ▶ [Pajtim](#) / [Empajtim](#)
- 19:00 Mbledhja Gala e Samitit II të Diasporës Shqiptare ▶ [Pajtim](#) / [Empajtim](#)
Diskutimi i mbyllë "Diaspora në Ballë e Shqipërisë"
Diskutimi i mbyllë "Shërbimet e Diasporës"
- 20:30 Darkë e lirë

"Politikat Shtetërore për Diasporën" përkthehet vullnetarisht në gjuhën italiane nga rrjeti I avokatëve shqiptar



Përfaqësuesit e rrjetit të avokatëve gjatë vizitës në Itali i dhuruan ministrit të Shtetit për Diasporë, z. Pandeli Majko librin "Politikat Shtetërore për Diasporën" të përkthyer në italisht në mënyrë vullnetare nga anëtarët e rrjetit të avokatëve shqiptar në Itali.

Përkthimin e "Politikat Shtetërore për Diasporën" në gjuhën italiane mund ta lexoni të plotë këtu:

<https://online.flippingbook.com/view/43789>

02

MARS

SAMITI I IIIND I DIASPORËS

- 09:30 Njësia drejt Lezhës ▶ [Pajtim](#) / [Empajtim](#)
- 12:00 Ceremonia e 575 vjetorit të Besëlidhjes së Lezhës ▶ [Pajtim](#) / [Empajtim](#)
- 13:00 Darkë buffet në nder të pjesëmarrësve në Samit nga kryetari i Bashkisë së Lezhës ▶ [Pajtim](#) / [Empajtim](#)
- 15:30 Njësia drejt Tiranës
- 17:30 Mbledhja në Tiranë
- 18:00 Darkë e lirë

Nisin aplikimet për Programin Kombëtar të Praktikave të Punës

Në kuadër të Programit Kombëtar të Praktikave të Punës dhe në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.395, datë 29.04.2015, " Për Miratimin e Programit Kombëtar të Praktikave të Punës në Administratën Shtetërore dhe Institucionet e tjera Publike" i ndryshuar, ju informojmë se në muajin shkurt hapet thirrja e katërt për vitin 2019. Programi është parashikuar të realizohet për një periudhë tre – mujore, përkatësisht në muajt mars, prill dhe maj për institucionet e administratës shtetërore, në nivel qendror e vendor.

Qëllimi i programit të praktikave është të aftësojë studentët me përvojë pune, duke zhvilluar kompetencat e tyre profesionale, akademike, personale dhe të njihen me sistemin e administratës publike.

Target-grup janë të rinj profesionistë 21 deri 26 vjeç, të cilët kanë mbaruar minimalisht ciklin e parë të studimeve bachelor. Periudha e praktikës së zhvilluar do të njihet si përvojë pune gjatë procedurave të rekrutimit në institucionet e Administratës Publike.

Prioritet për këtë thirrje, do të jetë zgjerimi i Programit dhe rritja e numrit të praktikantëve, që do të përfshihen në program.

Për aplikimin dhe informacione më të detajuara klikoni këtu: <http://praktika.arsimi.gov.al>



Praktikë pranë Kryeministratë



Praktikë pranë Ministratë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë



Praktikë pranë Ministratë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale



Praktikë pranë Ministratë e Turizmit dhe Mbrojtjes së Turizmit dhe Mbrojtjes së Turizmit



Praktikë pranë Ministratë e Energjisë



Praktikë pranë Ministratë e Kulturës



Praktikë pranë Ministratë e Drejtësisë



Praktikë pranë Kuvendit



Praktikë pranë Ministratë të Shetit për Detaportin



Praktikë pranë Ministratë e Evropës dhe Punëve të Jashtme



Praktikë pranë Ministratë e Financës dhe Ekonomisë



Praktikë pranë Ministratë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

